



## Parashtrimi i kërkesës për çertifikatë policore jashtë vendit

Secili person që i ka mbushur 14 vjet mund të paraqes kërkesë për lëshim të një çertifikate policore. Personat, të cilët banojnë jashtë vendit, kërkesën për lëshim të çertifikatës policore mund ta paraqesin drejtëpërdrejtë në Entin Federal të Drejtësisë

Informata më të hollësishme për këtë, si dhe formularët përkatës i gjeni në faqen zyrtare të internetit të Entit Federal të Drejtësisë në vegëzën e mëposhtme:

[https://www.bundesjustizamt.de/DE/Themen/Buergerdienste/BZR/Ausland/Antrag/FAQ\\_node.html](https://www.bundesjustizamt.de/DE/Themen/Buergerdienste/BZR/Ausland/Antrag/FAQ_node.html)

Për vërtetimin e nevojshëm të nënshkrimit, fillimisht duhet të caktohet një termin në rubrikën „Çështje të tjera konsullore“. Linku që çon në sistemin e caktimit të termineve gjendet në faqen zyrtare të internetit të ambasadës.

Në bazë të përvojës së ambasadës, vërtetimi i nënshkrimit nga institucionet kosovare nuk është i mjaftueshëm.

Personi që paraqet kërkesën duhet të dëshmojë identitetin dhe, nëse bëhet fjalë për një përfaqësues ligjor, autorizimin e përfaqësimit.

Pas caktimit të terminit, me vete në ambasadë duhet të sillen dokumentet vijuese në origjinal:

- ✓ Pasaporta e udhëtimit ose letërnjoftimi i parashtruesit të kërkesës
- ✓ Dëshmia/Vërtetimi i qëndrimit të zakonshëm në Kosovë

Në rastin e parashtruesve minorenë, duhet domosdo në termin të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi/it ligjor/ë. Në këto raste duhet të sillen bashkë me dokumentet e cekura nën 1. dhe 2. edhe dokumentet vijuese:

- ✓ Çertifikata e lindjes së parashtruesit minoren
- ✓ Pasaporta e udhëtimit ose letërnjoftimi i përfaqësuesit/es ligjor/e

Në kërkesë duhet të shenohet një adresë në të cilën mund të dërgohet çertifikata policore. Dërgimi i çertifikatës policore në ambasadë është i mundur vetëm në raste të specifike të arsyetuara. Në rast se çertifikata duhet të dërgohet në adresë të një të autorizuari, me kërkesë duhet të dorëzohet autorizimi dhe të shenohet adresa e të autorizuarit.



Çertifikata policore lëshohet vetëm në gjuhën gjermane. Përkthimi eventual i saj duhet të organizohet nga vetë parashtruesi i kërkesës.

Për vërtetimin e nënshkrimit nga ana e ambasadës llogaritet tarifa në vlerë prej 20,- euro, e cila duhet të paguhet në sportel. Tarifat e tjera për çertifikatën policore duhet të paguhet drejtëpërdrejtë në Entin Federal të Drejtësisë, zakonisht nëpërmjet transferit. Këto tarifa shprehimisht nuk mund të bëhen në ambasadë. Klientët me rastin e paraqitjes së kërkesës për këtë çështje e marrin një fletëinformacion të Entit Federal të Drejtësisë.

**Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.**